



Shqiperia e 17-vjecareve e ka nisur me humbje fazen eliminatore te Euro 2015. Ndeshja e pare e luajtur ne Korce ka perfunduar me rezultatin 0-1 per skuadren e Rumanise. Djelmoshat e Xhemal Mustedanagic kane bere nje ndeshje te mire me ritem te larte por nuk arriten te merrnin fitoren e shume deshiruar. Nje numer I madh spektatoresh, prinderish dhe njerezish te interesuar per te pare lojtaret e rinj ne moshe kane qene te pranishem ne stadiumin “Skenderbeu”. Ne pjesen e pare Zoizi, mesfushori shqiptar qe luan per Breshian ne Itali ishte prane golit por gaboi ne finalizim. Edhe Bakalli njesoj si ai dhe Shqiperia humbi dy mundesi mjaft te mira. Ne pjesen e dyte serish loja nisi njesoj me kuqezinjte ne sulm dhe rumunet ne mbrojtje. Nje kundersizim I miqve solli golin e pare dhe te vetem takimit I shenuar nga Ivan. Rezultati deri ne fund mbeti I pandryshuar dhe rumunet ne Korce moren tre piket qe u duheshin. Me kete humbje, Shqiperia e nis ne menyren me te keqe fazen kualifikuese qe do te zhvillohet ne vendin tone. Ne grupin 1 bejne pjese edhe Bjellorusia e Finlanda te cilat u ndeshen ne qytetin e Pogradecit dhe e mbyllen 80 minuteshin ne favor te bjelloruseve. Faza e pare e eliminatorëve parashikon 6 ndeshje ku 2 skuadrat e para te grupit do te kualifikohen per ne “Elite Round